

7

DPK/DMP	03-1241/13
02	23.04.2013

AGJENC.
KUNDËRVAJTËS

KA.nr.357/2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mejreme Zekaj kryetare, Ramiz Kuqi dhe Ragip Namani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale-procesmbajtëse, Sabahate Hoti, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga e pandehuri Qemajl Muharrem Krasniqi, nga fshati Medvec Komuna e Prizrenit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore- Divizioni Kundërvajtës në Prizren Nr.466-05/2012 i datës 09.01.2013, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 konform neni 222 të Ligjit për kundërvajtjet, më 25.03.2013, merr këtë:

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore- Divizioni Kundërvajtës në Prizren Nr.466-05/2012 i datës 09.01.2013, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore- Divizioni i Kundërvajtës në Prizren me aktvendimin Regj.nr.466 05/2012 i datës 09.01.2013, të pandehurin Qemajl Krasniqi, nga fshati Medvec Komuna e Prizrenit e ka shpallur përgjegjëse: sepse i njëjti në cilësinë e zyrtarit të lartë publik nuk ka përmbushur obligimin ligjor që parashihet me Ligjin nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 5,6 par.1 pika 3 dhe neni 9 lidhur me nenin 17 par.1 pika3 të Ligjit nr. 04/L-050 dhe i është shqiptuar gjoja në shumën prej 500,00 (pesëqind) €

Me të njëjtin aktvendim i pandehuri obligohet që në emër të shpenzime gjyqësore të paguaj shumën paushalle prej 5€.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Qemajl Krasniqi, ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të dispozitave procedurale dhe vendimit mbi dënimin me arsyetim se me formularët nga viti i kaluar e ka pasqyruar gjendjen reale të pasurisë, por fakti që nuk e ka përmendur ndonjë ndryshim të vogël gjykata e ka marr se ka kryer kundërvajtje dhe i ka shqiptuar dënim. se gjykata ka vendos vetëm në bazë të deklaratës së tij pa u lëshuar në provat tjera dhe pa i përmendur rrethanat lehtësuese që kanë ndikuar në një dënim të tillë Propozon që aktvendimi i atakuar të ndryshohet, të lirohet nga përgjegjësia ose ti shqiptohet dënim më i butë ose lënda të kthehet në rivendosje.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, si dhe shkesat tjera të lëndës dhe konstatoi sipas detyrës zyrtare se ankesa e paraqitur është e bazuar kurse aktvendimi i goditur abrogohet dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Kolegji konstatoj sipas detyrës zyrtare se ankesa e paraqitur është e bazuar për shkak se: dispozitivi i aktvendimit të goditur është konfuz dhe i pa qartë, andaj si i tillë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave procedurale përkatësisht në shkelje të nenit 205 al.1 pika 1 të LK-së sepse:

Përshkrimi i kundërvajtjes me të cilën ngarkohet i pandehuri nuk i përmban faktet dhe rrethanat të cilat e formojnë tiparin e kundërvajtjes prej të cilave varet aplikimi i dispozitës përkatëse, gjegjësisht nga dispozitivi nuk mund të kuptohet se në ç'kohë –vit ose periudhë ngarkohet i pandehuri se e ka kryer kundërvajtjen. Kurse dispozita sanksionuese, sipas të cilës i pandehuri është shpall përgjegjës përkatësisht neni 17 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit nr.04/L - 050 e parasheh përgjegjësin kundërvajtëse për personat që nuk veprojnë **sipas kërkesës së Agjencisë**, andaj duke marr parasysh përshkrimin e kundërvajtjes në dispozitiv të aktvendimit të goditur nuk mund të kuptohet se për cilin lloj të mosdeklarimit të pasurisë bëhet fjalë në rastin konkret, duke marr për bazë se ligji i parasheh tri mënyra të deklarimit të pasurisë. Për arsye të cekura më lartë, aktvendimi i goditur është i paqëndrueshëm nga se përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, andaj si i tillë abrogohet kurse lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Në plotësim të procedurës Gjykata e shkallës së parë, duhet të kryej këto veprime procedurale: që ta ftoj në mënyrë të rregullt parashtruesin e kërkesës dhe ta merr në pyetje me procesverbal për të dhënë sqarime për kohën – vitin për të cilin ngarkohet i pandehuri se nuk e ka deklaruar pasurinë, se për cilin lloj të mosdeklarimit të pasurisë e ngarkon të pandehurin dhe eventualisht ta bëjë rikualifikimin e veprës, sipas nevojës të nxjerrë edhe prova tjera dhe pas eliminimit të shkeljeve esenciale të theksuara më lartë dhe pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të nxjerrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në Ligj, duke marrë për bazë edhe pretendimet e paraqitura në ankesën e parashtruar.

Konform të nenit 222 të LK, u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk ka vend ankesë.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS.

AK.nr.357/2013 të dt.25.03.2013

Procesmbajtësja

Sebahate Hoti

KRYETARJA E KOLEGJIT,

Mejreme Zekaj

